

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 27-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuale**  
**mbajtur më 01.07.2024**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë:** Lazo Petrushevski, kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini, zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, Llazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë:** Dr. Metodija Jançeski.

**Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.**

**Të pranishëm nga shërbimi profesional:** mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, mr. Emilija Petreska Kamenjarova, Arben Saiti, Maja Damevska.

**Të pranishmit e tjerë: /**

Z. Petrushevski hapi seancën e 27-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:30 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Z. Petrushevski informoi se në seancë janë të pranishëm pesë anëtarë të Këshillit, mungon z. Jançeski i cili aktualisht është duke mbajtur provim në fakultetin ku punon. Ai ka shpjeguar se para se të fillojë seanca, përmes telefonit ka njoftuar për arsyen e mungesës dhe në atë drejtim janë pajtuar që të mos marrë pjesë në seancë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 5 vota "pro", miratoi:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 7- të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 12.06.2024.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 26- të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 12.06.2024.
3. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë për shkelje të nenit 67 paragrafi (6) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

4. Propozim -vendim për ndryshimin e strukturës së pronësisë të SHTR ALSAT-M SHPK nga Shkupi.
5. Propozim për dhënien e miratimit për miratimin e Aktvendimeve për ndërprerjen e vlefshmërisë së kontratës së punës.
6. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtje dhe servisim i mjeteve motorike zyrtare.
7. Propozim për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për blerjen e mallrave - Pllakë Gravoglas e gdhendur me laser, me vlerë të parashikuar nën kufijtë e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim publik.
8. Të ndryshme.

### **Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri, me 5 vota "pro", miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 7-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 12.06.2024, me tekstin e propozuar.

### **Pika 2**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri, me 5 vota "pro", miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 26-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më datë 12.06.2024, me tekstin e propozuar.

### **Pika 3**

Z. Trajçeovski shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë për shkelje të nenit 67 paragrafi (6) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Ai ka shpjeguar se gjatë mbikëqyrjeve të rregullta ndaj këtij transmetuesi është konstatuar se pjesa më e madhe nuk ka mundur të realizohet për shkak se radiodifuzeri ka transmetuar vetëm program muzikor. Për atë arsye, është bërë mbikëqyrje e jashtëzakonshme programore, sipas detyrës zyrtare, për realizimin e konceptit programor që TV GURRA nga Kërçova ka raportuar në Agjenci, në periudhën prej 3 deri më 9 qershor 2024. Siç thuhet në Raport, nga potenciali 168 orë program televiziv për një javë, SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, aspak nuk ka transmetuar program për 89 orë 42 minuta dhe 38 sekonda dhe për 78 orë 17 minuta dhe 22 sekonda ka transmetuar në veçanti vetëm spote muzikore. Në atë drejtim, propozohet që të shqiptohet masë vërejtje publike, më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli dhe shpreson që në përputhje me Ligjin, do të fillojë të transmeton program sipas konceptit programor, por nëse nuk vepron, masa tjetër përfundimtare është heqja e lejes.

Z. Petrushevski tha se praktika e viteve të kaluara disi tregon se kur transmetuesi fillon të sillt kështu, kur nuk mund të transmetojë program, ky është një tregues se po shkon në drejtim të anulimit(mohimit) të lejes. Në këtë drejtim, ai ka kërkuar nga Shërbimi që të bëjë përpjekje maksimale për të kontaktuar me transmetuesin dhe për ta informuar se ka afate që duhet të respektohen për tu harmonizuar me Ligjin, për të bërë përpjekje për të vazhduar punën.

Z. Trajçevski shpjegoi se TV GURRA nga Kërçova në fillim të këtij viti, me e-mail e ka njoftuar Agjencinë se do të ndërpresë punën dhe më pas ka ndryshuar qëndrimin se do të bëjë ende përpjekje, se do të gjejë investitor për ta mbajtur mediumin, por deri tani rezultati është siç tregon Raporti i mbikëqyrjes.

Z. Petrushevski tha se qëllimi i tij dhe i anëtarëve të Këshillit është që në maksimum t'i ndihmohet çdo transmetuesi që të vazhdojë punën, por nga ana tjetër Këshilli në vazhdimësi e respekton Ligjin dhe shpreson se mediumi do të mbijetojë.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të jashtëzakonshme programore, sipas detyrës zyrtare, nr.10-2753/1, datë 13.06.2024 dhe njëzëri konkludoi që SHTR TV GURRA SHPKNJ Kërçovë t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 67 paragrafi (6) të LSHMAAV, sepse në javën prej 3 deri më 9 qershor 2024, shërbimi programor i transmetuesit nuk ka zbatuar së paku 80 % të konceptit programor për të cilin i është dhënë leja për transmetim televiziv.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, është udhëzuar që në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Akvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Akvendimin për vërejtje publike, të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

#### **Pika 4**

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, mr. Magdalena Davidovska Dogleva, shpjegoi Propozimin për miratimin e vendimit për ndryshimin e strukturës së pronësisë të SHTR ALSAT-M SHPK nga Shkupi. Ajo shpjegoi se pronarë të TV Alsat-M janë një person juridik që zotëron 99.862% të pronësisë dhe dy persona fizikë që secili individualisht zotëron 0.069% të pronësisë. Kërkesa e paraqitur për të cilën kërkohet pëlqimi për ndryshimin e strukturës së pronësisë, i referohet përfaqësimit të njërit nga dy personat fizikë dhe pjesën prej 0,069% e ndërmerr personi tjetër fizik. Në këtë drejtim, sektori ka kryer verifikim në Regjistrin Qendror të RMV-së dhe është konstatuar se nuk ka pengesa ligjore për miratimin e këtij ndryshimi.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim me të cilin lejohet ndryshimi i strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive ALSAT-M SHPK nga Shkupi.

Me propozimin e ndryshimeve të strukturës së pronësisë së Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive ALSAT-M SHPK nga Shkupi nuk krijohet koncentrim i palejuar mediatik në kuptimin e LSHMAAV, gjegjësisht ky ndryshim nuk është në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) ose 38 nga Ligji i njëjtë.

Sektorit për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit Vendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

## **Pika 5**

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimet për dhënien e miratimit për miratimin e dy Aktvendimeve për ndërprerjen e vlefshmërisë së Kontratës së punës. Ai ka shpjeguar se është dorëzuar kërkesë personale nga e punësuarja dhe punonjës i Agjencisë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Kërkesat janë paraqitur gjatë kohës së zgjedhjeve, kur Kodi Zgjedhor nuk lejonte punësime ose shkarkim të punonjësve të sektorit publik gjatë kohës së zgjedhjeve. Për këtë arsye, Këshilli i Agjencisë në seancë për të dy rastet ka marrë vendim për pushimin (ndërprerjen) e marrëdhënies së punës deri në përfundim të procesit zgjedhor. Meqë tashmë ka përfunduar, propozohet që dy punonjësve tu mbaron Marrëveshja e punës me kërkesë të tyre.

Z. Petrushevski dha shpjegim për anëtarët e Këshillit, se për të dy të punësuarit, roli i Këshillit është që ta pranojnë propozimin dhe t'i japin miratim drejtorit të Agjencisë që të miratohen dy Aktvendime për të punësuarën dhe të punësuarin për mbarimin e vlefshmërisë së Kontratës së punës.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri dha pëlqimin që Drejtori i Agjencisë të miratojë Aktvendim për mbarimin e vlefshmërisë së Kontratës së punës, ark.nr.04-3809/1 datë 04.06.2015, me Aneks (shtojcë) nr.1 ark.nr.04-7272/1 datë 30.12.2012, Aneks nr.2 ark.nr.04-4159/1 datë 26.09.2017, Aneks nr.3 ark.nr.04-201/1 datë 11.01.2019, Aneksnr.4 ark.nr.04-430/1 datë 29.01.2019, Aneks nr.5 ark.nr.04-359/1 datë 24.01.2020, Aneks nr.6 ark.nr.04-453/1 datë 02.02.2021, Aneks nr.7 ark.nr.04-453/1 datë 30.07.2021, Aneksnr.8 ark.nr.04-453/1 datë 01.12.2021, Aneks nr.9 ark.nr.04-2625/1 datë 01.07.2022, Aneks nr.10 ark.nr.04-2625/1 datë 28.12.2022, Aneks nr.11 ark.nr.04-1241/1 datë 20.03.2023 dhe Aneks nr.12 ark.nr.04-1241/1 datë 24.08.2023, lidhur ndërmjet Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe të punësuarës, për vendin e punës Bashkëpunëtor për planifikim strategjik dhe mbikëqyrje administrative në Njësinë për planifikim strategjik në Sektorin për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, i cili pushon së vlefshmi me renoncim, me rastin e Deklaratës me shkrim, ark.nr.0401-1108/1 datë 06.03.2024, të punonjësit në fjalë, për renoncimin e Kontratës për punësim.

Kontrata e punës nga Aktvendimi i mësipërm pushon së vlefshmi që nga data 18.03.2024.

Njësia për çështje administrativo-juridike pranë Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik ta çregjistrojë të punësuarin në Agjencinë për punësim të RMV-së Qëndrës për punësim të qytetit të Shkupit (Formulari M1/M2, nga sigurimi i detyrueshëm shoqëror).

- Këshilli i Agjencisë njëzëri dha pëlqimin që Drejtori i Agjencisë të miratojë Aktvendim për pushimin e vlefshmërisë së Kontratës së punës ark.nr.04-2988/1 datë 31.07.2023. me Aneks nr.1 ark.nr.04-2988/1 datë 29.08.2023, lidhur ndërmjet Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe të punësuarit, për vendin e punës Bashkëpunëtor për logjistikë dhe mirëmbajtjen vijuese në Njësinë për punë materiale dhe logjistikë pranë Sektorit për financa dhe logjistikë, i cili pushon së vlefshmi me renoncim, me rastin e Deklaratës me shkrim, ark.nr.0401-729/2 datë 16.02.2024, të punonjësit në fjalë, për renoncim të Kontratës për punë.

Kontrata e punës nga Aktvendimi i mësipërm pushon së vlefshmi që nga data 01.03.2024.

Njësia për çështje administrativo-juridike pranë Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik ta çregjistrojë të punësuarin në Agjencinë për punësim të RMV-së Qëndrës për punësim të qytetit të Shkupit (Formulari M1/M2, nga sigurimi i detyrueshëm shoqëror).

## **Pika 6**

Z. Trajçevski në lidhje me Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Mirëmbajtja dhe servisimi i mjeteve motorike zyrtare, duke qenë se nuk ndërhyjnë në përgatitjen e specifikimeve teknike, dha një propozim. Ai shpjegoi se për kompaninë aktuale të zgjedhur për këtë qëllim ka ankesa të vazhdueshme nga dy drejtuesit e automjeteve të cilët thonë se shërbimi për mirëmbajtjen dhe servisimin e mjeteve motorike zyrtare është jashtëzakonisht joprofesional, joadekuat, punonjësit për ndryshimin e llambave shohin dhe në internet si ta nderrojnë, kondicioneri në makine nuk mund ta rregullojnë e kështu me radhë. Në këtë drejtim dha një propozim, nëse është e mundur që në specifikacionin teknik t'i kushtohet më shumë rëndësi cilësisë dhe jo vetëm çmimit, sepse duke zgjedhur çmimin më të ulët mund të lidhet kontratë me një kompani që nuk di të bëjë ndonjë riparim, shërbim ose mirëmbajtje. Ai propozoi që nëse është e mundur të miratohet nevoja për zbatimin e kësaj procedure për furnizim publik, dhe më pas të korrigjohet specifikimi teknik dhe t'u dorëzohet anëtarëve të Këshillit si informacion.

Z., Petrushevski tha se në parim Këshilli asnjëherë deri më tani nuk ka ndërhyrë në përgatitjen, gjithmonë kanë votuar vetëm për nevojën e furnizimit publik.

Z. Trajçev tha se anëtarët e Këshillit gjithmonë kanë votuar vetëm për përcaktimin e nevojës për realizimin e furnizimit publik, ndërsa mënyra e realizimit dhe procedura e përgjithshme është përgjegjësi e drejtorit dhe shërbimit. Në çfarë mënyre dhe si do të realizohet i takon drejtorit. Ai shpjegoi se gjithmonë në parim ka pranuar që të zgjidhet me çmimi më i ulët sepse Agjencia ka në dispozicion para publike shtetërore dhe Këshilli duhet të kujdeset për shfrytëzimin e tyre efikas. Qëndrimi i tij është se ata nuk kanë të drejtë të ndërhyjnë në specifikimet teknike dhe mënyrën se si furnizimet publike do të realizohen. Në veçanti, Këshilli vetëm miraton nevojën për zbatimin e kësaj procedure.

Z. Fidanoski tha se do të mbështesë miratimin e këtij furnizimi publik. Në parim, në lidhje me furnizimet e tilla publike, për disa prej tyre, ai tha që të bëhet një raport në çmim dhe cilësi që në fund do të japë një produkt të mirë, të zgjidhet operator ekonomik që do t'i përgjigjet plotësisht kërkesave të specifikacionit teknik. Ai u pajtua me Z. Trajçev se nuk duhet të ndërhyjnë në përgatitjen e specifikacionit teknik, por këtu tashmë po flitet për sigurinë e pasagjerëve në veturat zyrtare dhe do të ishte mirë që të bëhet një specifikim i tillë që në fund të ndikojë në mënyrë drastike në çmim në raport me shumën, por gjithsesi të ofrojë shërbim përkatës që do të mund siç duhet të mirëmbajë dhe servisojë ato automjete.

Z. Petrushevski tha se nuk e di nëse ka ndryshime në ligj, por ndoshta Ligji lejon që çmimi të mbetet si kriter për përzgjedhje dhe cilësia të kërkohej përmes aftësisë teknike dhe profesionale, që do të thotë me një numër më të madh të punësuarish, të ardhura më të mëdha, dhe pastaj ndoshta nuk do të paraqiten 10 kompani, do të paraqiten 3, por sigurisht që furnizimi do të realizohet duke respektuar ligjin.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik Cvetanka Mitrevska, shpjegoi se bëhet fjalë për furnizim me vlerë të ulët dhe për këtë arsye nuk mund të përdoret raporti më i mirë në mes të çmimit dhe cilësisë, por si kriter për përzgjedhje është çmimi më i ulët. Ajo ka thënë se mund të bëhet edhe ndryshe duke respektuar dispozitat e Ligjit për furnizim publik. Lidhur me këtë furnizim publik, ajo informoi se janë përmbushur të gjitha normat ligjore, ndërsa në lidhje me sugjerimet që janë dhënë, tha se në takim është i pranishëm dhe udhëheqësi Arben Saiti, i cili ka dëgjuar të gjitha vërejtjet sepse nga sektori i tij është përgatitur specifikimi teknik dhe beson se do të veprojë sipas asaj që u tha.

Z. Petrushevski tha se ajo që tha z. Fidanoski është shumë e rëndësishme, bëhet fjalë për rrezik të mundshëm për jetën e udhëtarëve nëse automjetet janë me defekt dhe duhet kushtuar vëmendje maksimale për marrjen e masave për sigurinë e tyre dhe sigurinë në komunikacion. Ai vuri në dukje se i mbetet shërbimit të vlerësojë nëse do të marrë parasysh indikacionet e dhëna në diskutim, dhe përgatitja e specifikimit teknik është në duart e tyre.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtje dhe servisim i mjeteve motorike zyrtare, për 2 (dy) vjet.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-shërbim: Mirëmbajtje dhe servisim i mjeteve motorike zyrtare për 2 (dy) vjet, për nevojat e Agjencisë, është parashikuar dhe është në përputhje me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2024, të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4729/1 datë 22.12.2023, ndërsa mjetet sigurohen me Planin financiar të Agjencisë për shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024, gjegjësisht të njëjtit do të sigurohen me Planin financiar për vitin 2025.

## **Pika 7**

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, ka shpjeguar propozimin për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për furnizim të mallit - Pllakë Gravoglas e gdhendur me laser, me vlerë të parashikuar nën kufijtë e vlerës për zbatimin e ligjit për furnizim publik. Ajo shpjegoi se për furnizimet që janë nën pragun e vlerës, gjegjësisht nën 1000 euro në kundërvlerë në denarë nuk vlejné dispozitat nga Ligji për furnizim publik, por për të siguruar transparencë në procedurë janë ofruar dy oferta, nga të cilat pranohet oferta që është ekonomikisht dhe financiarisht më fitimprurëse për Agjencinë.

Z. Trajçevski shpjegoi se ky furnizim publik ishte vënë në Rend dite në një nga seancat e kaluara, por për shkak të procesit zgjedhor është shtyrë deri në përfundimin e zgjedhjeve.

Z. Trajçev tha se edhe këtu Këshilli vendos sipas nevojës. Ai ka shpjeguar se edhe më herët ka reaguuar se është mirë të kërkohen më shumë se dy oferta në situata të tilla ku nuk ka procedurë në pajtim me Ligjin për furnizim publik dhe të ketë mundësi më të madhe për zgjedhje.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratimin që Drejtori i Agjencisë të marrë vendim për furnizim të shërbimit – Përgatitja e tebelës, për Agjencinë, me vlerë të parashikuar nën kufijtë e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim publik, në shumë prej 34.810,00 denarë me TVSH.

Shërbimi i lartpërmendur – Përgatitja e tabelës, nuk është paraparë në Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2024 të Agjencisë, sepse shërbimi është me vlerë të parashikuar nën kufijtë e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim publik.

Për realizimin e shërbimit të lartpërmendur, mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024.

**Pika 8**

**Të ndryshme**

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuele  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**